



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration



Për :	Xhafer Gashi , Kryetar i Komunës së Obiliqit Burim Gërguri , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Obiliqit	
Cc:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	<i>per</i> Ivan Todosijević , Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj , Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Xhevat Tafa , U.d Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL	Datë: 05/11/2018
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së Aktit të Kuvendit të Komunës së Obiliqit	Nr. 020-1270
Lloji i aktit	Vendim	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 1-170 paraprak për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës së Paluajtshme të Komunës së Obiliqit
I miratuar më datë: 30.10.2018
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 02.11.2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural **është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration



Za :	Xhafer Gashi , gradonačelnik Opštine Obilić Burim Gërguri , predsedavajući Skupštine opštine Obilić
Cc:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jednici za administraciju dokumenata u opštini
Preko:	Ivan Todosijević , ministar MALS-a Rozafa Ukimeraj , generalna sekretarka MALS-a
Od:	Xhevat Tafa , v.d rukovodilac Odeljenja za zakonska pitanja i monitorisanje opština
Predmet:	Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine Obilić
Vrsta akta	Odluka

Datum: 05/11/2018
Br. 020-1270

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsedavajući

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Preliminarna odluka br.1-170 za davanje nepokretne imovine opštine Obilić na kratkoročno korišćenje
Usvojena dana, 30.10.2018.godine
Poredložena za razmatranje u MALS-u dana, 02.11.2018. godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je isti u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravni učinak. Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštine za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



Shkëlqimshëm,
nr. 11-170 Data 30-10-2018
Z. Pajtim
Pajtim

REPUBLICA E KOSOVËS
MINISTRI E ADMINISTRIMIT TË PUSHËTËSH LOKAL
Ministère e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministère e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministry of Local Government Administration

02-11-2018

Q. Sh. (Kryetar)	Q. Sh. (Zëritar)	Q. Sh. (Kryetar)	Q. Sh. (Zëritar)
-01-	010-	1270	



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.14 (17 pika e) dhe nenit 58 pika h), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr 03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 6,7 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr 04/L-144 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës e datës 22 nëntor 2012, neneve 11,12 të Rregullores nr.23/2013 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 72 pika 1.1.8 Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.1-34 të datës 25.04.2016, propozim vendimit i Kryetarit të Komunës me nr 11-774 dt.13.09.2018.

Kuvendi Komunal në mbledhjen e mbajtur me date 30.10.2018 mori këtë:

VENDIM

PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË SHTËPISË SË KULTURËS E CILA GJENDET NË MILLOSHEVË

Neni 1

Me këtë Vendim ipen në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik Shtëpia e Kulturës e cila gjendet në Parcelën Kadastrale :

- Ngosra kadastrale P-72614051-00619-0.Lloji njësisë-Parcelë, vendi i quajtur "VISHE SELA SELO" Shfrytëzimi aktual-Tokë Ndërtimore-Shtëpi-Ndërtesë-Tokë Ndërtimore-Oborr, me sipërfaqe prej 3964 m², pjesa e pronës 1/1 e evidentuar në Çertifikatën e pronës nr.05-1769-2018 e dt.17.07.2018, z.k.Milloshëvë K.Obiliq e evidentuar si P.SH.SHKOLLJA FILLORË MILLOSHEVË.
- Ndërsa numri i objektit të Shtëpisë së Kulturës është,
- O-72614051-00619-0-588-0.Lloji i njësisë-Ndërtesë, vendi i quajtur "VISHE SELA SELO" Shfrytëzimi aktual-Shtëpi, me sipërfaqe prej 299 m², pjesa e pronës 1/1 e evidentuar në Çertifikatën e pronës nr.05-1769-2018 e dt.17.07.2018, z.k.Milloshëvë K.Obiliq e evidentuar si P.SH.SHKOLLJA FILLORË MILLOSHEVË.

Neni 2

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës- Shtëpisë së Kulturës në Milloshëvë është se Objekti i Shtëpisë së Kulturës është i pa shfrytëzuar por në gjendje të mirë fizike dhe është i përshtatshëm për zhvillimin e aktiviteteve kulturore, programeve edukative dhe veprimtarive të ndryshme profesionale me karakter kulturor, rinor dhe sportiv .

Neni 3

Sipas neni 1 të këtij vendimi, prona -Shtëpia e Kulturës në Milloshevë ipet në shfrytëzim afatshkurtër prej 5 vite (sipas kërkesës së DKRS-së) nëpërmjet ankandit publik të përcaktuar sipas Rregullores QRK, Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 4

Procedurën e konkursit publik e zbaton Komisioni Vlerësues sipas Vendimit të Kuvendit Komunal Nr 1-24 të dt,28.02.2018 si dhe në bazë të Rregullores QRK, Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës neni 4 paragrafi 4.1.

Neni 5

Obligohet Drejtoria për Gjendjezi Kadastër dhe Pronë që pas përfundimit të zbatimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës të paluajtshme të Komunës të regjistrojë në librat kadastral si pronë e dhënë në shfrytëzim afatshkurtër.

Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kulturë,Rini dhe Sport.

Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqe të Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për të miratuar këtë propozim Vendim është përcaktuar me dispozitat e neneve 12,14, 17 pika c) dhe neni 58 pika h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 6,7 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës e datës 22 nëntor 2012 .neneve 11,12 të Rregullores nr.23/2013 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së

paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 72 pika 1.1.8 Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.1-34 të datës 25.04.2016.

Me qëllim të realizimit të interesit publik, rritjes së vlerës ekonomike të pronës komunale si dhe ruajtjes së mjedisit, Komuna e Obiliqit ka planifikuar të jep në shfrytëzim afatgjatë në periudhë 1 deri 5 vite pronat e paluajtshme të Komunës të cekura në nenin 1 të këtij Vendimi .

Kuvendi i Komunës së Obiliqit
Nr.1- /2018- më 30 Tetor 2018

T'i dërgohet

- Kryetarit
- Kryesuesit
- Nënkryetarit
- Anëtarëve të Komisionit
- MAPU.
- Anëtarëve të Kuvendit
- Arkivit

Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Bërim Gërguri



REPUBLIC OF KOSOVO
 REPUBLIKA E KOSOVES
 Ministry of Administration and Local Government
 Ministria e Administrimit te Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
 Ministry of Local Government Administration

Date: 02.11.2018
 Deputi: []
 Titull: []

Shifra e Dokumentit	Shifra e Kartës	Shifra e Aktit
11-774	020-	1270

11-774 13.09.2018



Republika e Kosoves
 Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Qeveria-Vlada-Government

Komuna Obiliq - Opština Obilić - Municipality Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.14 .17 pika c) dhe nenit 58 pika h). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/I-010, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 7 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/I-144 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës e datës 22 nëntor 2012, neneve 4.5 të të Rregullores QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës ,nenit 72 pika 1.1.8 Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.1-34 të datës 25.04.2016 si dhe pas Kërkesës së Drejtorisë së Kulturës për Rini dhe Sport nr.XIV-90 të dt.14.08.2018, Kryetari i Komunës propozon që Kuvendi i Komunës në Mbledhjen e radhës të miratojë këtë:

PROPOZIM

VENDIM

PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË SHTRËPISË SË KULTURËS E CILA GJENDET NË MILLOSHEVË

Neni 1

Me këtë Vendim ipen në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik Shtëpia e Kulturës e cila gjendet në Parcelën Kadastrale :

-Ngastra kadastrale P-72614051-00619-0.1 loji njësisë-Parcelë, vendi i quajtur "VISHE SULA SELO" Shfrytëzimi aktual-Tokë Ndërtimore-Shtëpi-Ndërtesë-Tokë Ndërtimore-Oborr, me sipërfaqe prej 3964 m², pjesa e pronës 1/1 e evidentuar në Çertifikatën e pronës nr.05-1769-2018 e dt.17.07 .2018, zk.Milloshevë K.Obiliq e evidentuar si P.SILSHKOLLA FILLORE MILLOSHEVË.

Ndërsa numri i objekti i Shtrëpisë së Kulturës është:

-O-72614051-00619-0-588-0.1 loji i njësisë-Ndërtesë, vendi i quajtur "VISHE SULA SELO" Shfrytëzimi aktual-Shtëpi, me sipërfaqe prej 299 m², pjesa e pronës 1/1 e evidentuar në Çertifikatën e pronës nr.05-1769-2018 e dt.17.07 .2018, zk.Milloshevë K.Obiliq e evidentuar si P.SILSHKOLLA FILLORE MILLOSHEVË.

Neni 2

Qëllim i dhënies në shfrytëzim të pronës- Shtëpisë së Kulturës në Milloshevë është se Objekti i Shtëpisë së Kulturës është i pa shfrytëzuar por në gjendje të mirë fizike dhe është i përshtatshëm për zhvillimin e aktiviteteve kulturore, programeve edukative dhe veprimtarive të ndryshme profesionale me karakter kulturor, rinor dhe sportiv .

Neni 3

Sipas nenit 1 të këtij vendimi, pronë –Shtëpia e Kulturës në Milloshevë ipet në shfrytëzim afatshkurtër prej 5 vite (sipas kërkesës së DKRS-së) nëpërmjet aukandit publik të përcaktuar sipas Rregullores QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 4

Procedurën e konkursit publik e zbaton Komisioni Vlerësues sipas Vendimit të Kuvendit Komunal Nr.1-24 të dt.28.02.2018 si dhe në bazë të Rregullores QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës neni 4 paragrafi 4.1.

Neni 5

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë që pas përfundimit të zbatimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës të paluajtshme të Komunës të regjistrojë në librat kadastral si pronë e dhënë në shfrytëzim afatshkurtër.

Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kulturë, Rinë dhe Sport.

Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqe të Komunës.

Arsyetimi

Baza ligjore për të miratuar këtë propozim Vendim është përcaktuar me dispozitat e nenëve 12,14,17 pika c) dhe nenit 58 pika h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/1.-010, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 7 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës e datës 22 nëntor 2012, nenëve 4.5 të të Rregullores QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës ,nenit 72 pika 1.1.8 Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.1-34 të datës 25.04.2016 si dhe Kërkesa së Drejtorisë së Kulturës për Rinë dhe Sport nr.XIV-90 të dt.14.08.2018.

Me qëllim të realizimit të interesit publik, rritjes së vlerës ekonomike të pronës komonale (Shtëpisë së Kulturës) në Milloshevë si dhe zhvillimin e aktiviteteve kulturore, programeve edukative për arsye se Objekti i Shtëpisë së Kulturës është në gjendje të mirë fizike dhe aktualisht i pa shfrytëzueshëm, Komuna e Obiliqit ka planifikuar të jep në shfrytëzim afatshkurorë Objektrin e Shtëpisë së Kulturës në Milloshevë të cekur si në nenin 1 dhe 2 të këtij Propozim Vendiimi .

KRYETARI I KOMUNËS

Xhafer Gashi



Shtojcë :

-Certifikatë –Njësia Kadastrale

-Kopja e Planit



Republika e Kosovës

Republic of Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Sredine i Prostorinog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY


KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunalet/ Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office - OBILIG
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Milosheve

Nësi i Cënimat/Unit
P-72614651-00619-0

Tipi/Vrsta/Type
Parcela / Parcela / Parcel

Sipërfaqja/Površina/Area m²
3064.0



Skallë/Razmera/Scale: 1:750

Punë/Çikim/Created

Data/Date: 19.07.2018

Kimi/Vendi/Type: Ushqesore

Niveli i mëtejshëm/Çfarëdo

Shënim/Beleška/Note:

Aprovuar/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktori/Director

Niveli i mëtejshëm/Çfarëdo

